



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E VËZHguesve AFATSHKURTËR TË QENDRËS PËR
PERSPEKTIVË EVROPIANE (CEP), PËR VËZHgIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR, 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 06.06.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|----------|------------|
| Klement | ZGURI | Kryetar |
| Denar | BIBA | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI | Anëtare |
| Rezarta | BITRI | Anëtare |

OBJEKT: Miratimi i vëzhguesve afatshkurtër të paraqitur nga Qendra për Perspektivë Evropiane (CEP) të Republikës së Kosovës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor, 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Projekti "Forcimi i Transparencës së Zgjedhjeve: Shkëmbimi i përvojave midis Shqipërisë



Nr.799 i Vendimit

Data 06.06.2019

Ora 18 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Qendrës për Perspektivë Evropiane (CEP) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019

dhe Sllovenisë është duke u implementuar nga Qendra për Perspektivën Evropiane (CEP) në bashkëpunim me Komisionet Qëndrore të Zgjedhjeve të Shqipërisë dhe Sllovenisë dhe ka në fokus të saj të ndajë përvojat dhe praktikat më të mira lidhur me

transparencën llogaridhënien dhe angazhimin qytetar sa i përket zgjedhjeve si pjesë e proceseve demokratike.

Pjesë e projektit do të jetë dhe monitorimi i zgjedhjeve vendore 2019. Me ftesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, CEP-i ka paraqitur kërkesën bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ-së për akreditimin e 3 (tri) vëzhguesve afatshkurtër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4,5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Qendrës për Perspektivë Evropiane (CEP) për akreditimin e 3 (tri) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.2 .
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI | Anëtare |



Nr.799 i Vendimit

Data 06.06.2019 Ora 18 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Qendrës për Perspektivë Evropiane (CEP) për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019